



Република Македонија
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë
AVOKATI I POPULLIT

O M B U D S M A N
Republic of Macedonia

Avokati i Popullit-Mekanizmi Parandalues Nacional më datën 03.07.2014 realizoi **vizitë të jashtëzakonshme nate në Qendrën për pranimin e të huajve** me qëllim të përcaktimit të gjendjeve, se a ka përmirësim dhe në çfarë masë janë implementuar rekomandimet e dhëna paraprakisht nga vizitat e realizuara në vitin 2012 dhe 2013. Njëherazi, vizita e jashtëzakonshme pasoi pas grevës e cila ishte organizuar në Qendrën dhe kontrollës për masat që u ndërморën nga ana e ministrisë kompetente.

U konstatua përmirësim i kushteve në ambientet ku vendosen gra dhe fëmi, përkatësisht tek të njëjtët është përmirësuar higjiena, janë ngjyrosur muret pranë hyrjes në dhoma dhe në të njëjtën ka hapsirë të mjaftueshme për personat e vendosur. Gjatë bisedës me gratë dhe fëmijët MPN pranoi informatë se të njëjtët nuk janë të kënaqur nga ushqimi, shpeshherë barërat i blejnë me shpenzime të veta, ndërsa për fëmijët nuk sigurohet veshëmbathje përkatëse konform motit. Në pjesën ku janë vendosur persona të gjinisë mashkullore MPN pranoi ankesa se kujdesi mjeksor nuk u mundësohet me kontinuitet, nuk u sigurohen krevate për të gjithë personat prandaj disa prej tyre flejnë në tokë, nuk u jepet veshëmbathje përkatëse konform motit, edhe pse qëndrojnë në qendrën më gjatë se 5 muaj. Nga ana e drejtorit të Qendrës u vërtetua se nuk kanë veshëmbathje për donim, ndërsa sa i përket mungesës së shtresave dhe mbulesave, u dha informata se personat shpeshherë të njëjtën e grisin dhe shfrytëzojnë për nevoja tjera.

Megjithatë, edhe mëtej numri më i madh i ankesave i përket qëndrimit të gjatë në Qendrën (me ç'rast disa persona qëndrojnë 5-6 muaj), komunikimit të kufizuar me familjet vetëm për persona për të cilët ka përfunduar procedura gjyqësore. Një person theksoi se gjat kohës prej 6 muajve ka kontaktuar vetëm një herë me familjen e vet. Nga Drejtoria e Qendrës është dërguar lista e personave të cilët e kanë realizuar të drejtën për të kontaktuar me familjet e tyre, por mbetet problemi i personave të cilët e kanë statusin e pazgjydhur në procedurë gjyqësore.

Brengos zbatimin konsekuent i sigurimit të shetitjeve në ambient të hapur dy herë në ditë nga një orë për personat e huaj ose gjithsej dy orë, për arsye se vet objekti nuk është i rrethuar në mënyrë të sigurt dhe nuk ka hapsirë të mjaftueshme për realizimin e kësaj të drejte për të gjithë personat e vendosur në Qendër. Edhe pse nga drejtoria e qendrës u dha infaormata se personat mund ta realizojnë këtë të drejtë, gjatë bisedës me emigrantët MPN u njoftua se shetitja në vend që të realizohet për dy orë siç është parashikuar, shkurtohet për 15 ose 30 minuta.

Gjatë inspektimit në evidencën si dhe gjatë bisedës me shërbimet profesionale u konstatua se një pjesë e të huajve kanë paraqitur kërkesë për azil dhe se të njëjtët

duhet gjatë periudhës së ardhshme të vendosen në ent për këtë lloj të kategorisë së personave.